

PLANI I VEPRIMIT

Për Personat me Aftësi të Kufizuar në komunën e
Gjilanit
2024-2027

Të dashur qytetarë të Komunës së Gjilanit,

Me kënaqësi po ju prezantojmë "Planin e Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2024-2027." Ky dokument përfaqëson një angazhim të fuqishëm dhe të përkushtuar të Komunës sonë për të promovuar barazinë, përfshirjen dhe mbështetjen e plotë për të gjithë qytetarët tanë, pavarësisht nga aftësitë e tyre.

Nëpërmjet kësaj strategjie, ne synojmë të adresojmë sfidat dhe pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara dhe të krijojmë një mjedis që i mundëson atyre të jenë të barabartë në çdo aspekt të jetës së përditshme. Objektivat tona janë të qarta dhe të arritshme, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës publike, rritjen e aksesit në shërbime dhe fuqizimin e ndërgjegjësimit publik për të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Plani ynë i veprimit do të përfshijë masa konkrete dhe të matshme për të siguruar që asnjë individ nuk mbetet mbrapa. Kjo përfshin investime në arsim, punësim, shëndetësi dhe shërbime sociale të cilat janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët. Gjithashtu, do të fokusohemi në krijimin e mundësive për pjesëmarrje aktive në jetën publike dhe kulturore të qytetit tonë.

Ky plan nuk është thjesht një dokument politik, por një thirrje për veprim kolektiv dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Ne besojmë se vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe angazhimit të përbashkët mund të arrijmë qëllimet tona të përbashkëta për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.

Ju ftojme të gjithë të bashkoheni me ne në këtë rrugëtim për të ndërtuar një komunitet ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tij të plotë dhe për të kontribuar në komunitetin tonë të përbashkët.

Me respekt,

Alban Hyseni

Kryetar i Komunës së Gjilanit

Përmbatja

Parathënie	3
Përmbledhja	4
Plani i aktiviteteve	5-12

Parathënie

Personat me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit vazhdojnë e mbeten grupe të cilat Akoma kanë vështirësi të integrohen dhe të pranohen në mënyrë të barabartë, ndonëse ligjet në fuqi garantojnë të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë individët me aftësi të kufizuara kanë vështirësi në qasje infrastrukturore, në edukim të barabartë për të gjithë, shëndetësi, mirëqenie sociale e aktivitete kulturore.

Bazuar në nevojat, vështirësitë, kërkesat e grupeve të organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar, në vitin 2013 është hartuar Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për periudhë 10 vjeçare. Kjo strategji parasheh edhe krijimin e planeve komunale për aftësinë e kufizuar. Sidoqoftë në komunën e Gjilanit për kundër përpjekjeve të vazhdueshme akoma nuk është hartuar një plan i cili u mundëson institucioneve të zhvillojnë aktivitetet që mbështesin personat me aftësi të kufizuara.

Komuna e Gjilanit ka bërë përpjekje të vazhdueshme që personat me aftësi të kufizuara ti përfshij, duke promovuar potencialin e tyre tek bizneset dhe duke ofruar mbështetje përmes projekteve, megjithatë është vlerësuar se kjo është e pamjaftueshme dhe se vetëm një plan i detajuar i veprimit mund të ndihmojë në përmirësimin e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuar në qytetin e Gjilanit.

Plani aktual i veprimit për periudhën 2024-2027 për Personat me Aftësi të Kufizuar është rezultat i punës së Down Syndrome Kosova në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të komunës së Gjilan-it, mbështetur dhe financuar nga UNICEF në bashkëpunim me USAID në Kosovë. Grupi punues ka realizuar punëtori të cilat kanë shërbyer si mundësi për të identifikuar problemet dhe për të gjetur zgjidhjet më të përshtatshme bazuar në gjendjen aktuale të komunitetit me Aftësi të Kufizuara në komunën e Gjilan-it.

Përmbledhja

Plani Komunal i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar është një dokument publik i domosdoshëm i cili në mënyrë të detajuar përshkruan se si komuna dhe institucionet duhet ti qasen ndryshueshmërisë dhe kërkesave të personave me aftësi të kufizuara. Ky dokument përveç qasjes së sigurt dhe plotësimi të kërkesave për qëllim ka parandalimin e çdo forme të abuzimit, diskriminimit dhe trajtimit jo të barabartë që mund ti jetë bërë ose mund ti bëhet kësaj kategorie.

Ky dokument ndryshe mund të njihet si plan që ofron qasje dhe integrim të barabartë, duke i mundësuar kështu komunës që të arrijë qëllimet. Gjithashtu ky plan veprimi do u vihet në ndihmë institucioneve që nga afër ti kuptojnë më mirë nevojat e personave me aftësi të kufizuar dhe në këtë mënyrë të parandalohet çdo formë diskriminimi që mund të përballen ata në nivel komunal.

Plani i veprimit për personat me Aftësi të Kufizuar, përveç se mund të shërbejë si formë ndërgjegjësimi për institucionet komunale, do i mundësojë edhe komunës që të bëj një planifikim buxhetor i cili është gjithpërfshirës, ku në mënyrë të barabartë përfshihen edhe personat me Aftësi të Kufizuara.

Plani aktual i Veprimit për periudhën 2024-2027 për Personat me Aftësi të Kufizuar është rezultat i punës së Down Syndrome Kosova në bashkëpunim me Zyrën për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Gjilanit, Drejtorinë e Shëndetësisë, Zyrën për Fëmijët me Nevoja të Veçanta në Drejtorinë e Arsimit, Qendrën për Punë Sociale, mbështetur dhe financuar nga UNICEF në bashkëpunim me USAID në Kosovë. Ky grup ka realizuar punëtori të cilat kanë shërbyer si mundësi për të identifikuar problemet dhe për të gjetur zgjidhjet më të përshtatshme bazuar në gjendjen aktuale të komunitetit me Aftësi të Kufizuara në komunën e Gjilanit.

PLANI I AKTIVITETEVE

Objektiva 1	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale për personat me aftësi të kufizuara.										
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit				Indikatorët	Buxheti			
			2024	2025	2026	2027		2024	2025	2026	2027
1.1 Janë evidentuar personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë shërbime shëndetësore të veçanta në shtëpi.	Krijimi i regjistrit të veçantë të personave me aftësi të kufizuara dhe nevojat e tyre shëndetësore.	DSHMS / QKMF	X	X	X	X	Numri i personave të regjistruar		1,000	1,000	1,000
1.2 Janë ngritur kapacitetet e grupit të vizitave në shtëpi për identifikim të hershëm të aftësisë së kufizuar.	Organizimi i trajnimeve për identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar.	DSHMS	X	X	X	X	Numri i trajnimeve të organizuara Numri i personelit mjekësor të trajnuar	500	500	500	500
1.3 Është rritur ofrimi i shërbimeve në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara.	Organizimi i vizitave të rregullta periodike në familjet me persona me aftësi të kufizuara edhe kur nuk ka kërkesa nga familjarët.	QKMF	X	X	X	X	Numri i vizitave Numri i familjeve të vizituara		5,000	5,000	5,000
1.4 Është përmirësuar furnizimi i personave me aftësi të kufizuara me barna të nevojshme individuale.	Inicimi i ndryshimit të rregullores komunale për subvencionime.	DSHMS dhe QKMF	X				Shuma e lejuar e subvencionimit				
	Rritja e shumës së subvencionimit të barnave të	DSHMS	X	X	X	X	Shuma e subvencionimit e	2,000	2,000	2,000	2,000

	veçanta për personat me aftësi të kufizuara.						caktuar me rregullore				
1.5 Janë përmirësuar shërbimet terapeutike dhe psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara.	Kontraktimi i institucioneve jo-publike të licencuara për ofrimin e shërbimeve terapeutike dhe psiko-sociale	DSHMS/QPS /OJQ e licencuara	X	X	X	X	Numri i kontratave të dhëna OJQ-ve	15,000	60,000	70,000	80,000
1.6 Shërbime cilësore	Fuqizimi i mekanizmave për kontrollim dhe monitorim të institucioneve jo-publike të cilat ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara	Drejtoritë përkatëse					Numri i vizitave monitoruse - mbikëqyrëse nga Komuna ne OJQ përfituese te subvencioneve				
1.7 Është ngritur vetëdija e personelit mjekësor mbi aftësinë e kufizuar.	Prodhimi i materialeve vetëdijesuese.	DSHMS	X	X	X	X	Numri i materialeve të prodhuara	450	450	450	450
	Publikimi i materialeve vetëdijesuese në mediat sociale dhe përmes ekipeve të vizitave në shtëpi.	DSHMS	X	X	X	X	Numri i publikimeve Numri i vizitave në shtëpi	150	150	150	150
Objektiva 2	Përmirësimi i qasjes fizike në objekte publike për personat me aftësi të kufizuara.										
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit				Indikatorët	Buxheti			
			2024	2025	2026	2027		2024	2025	2026	2027
2.1 Janë ngritur kapacitete e personelit	Organizimi i seancave informuese për zyrtarë komunalë, veçanërisht	Drejtoria e Urbanizmit	X	X	X	X	Numri i zyrtarëve komunalë të trajnuar		500	500	500

zyrtar për aftësinë e kufizuar.	drejtoratit të urbanizmit për të vlerësuar projektet duke pasur parasysh lirinë e lëvizjes.										
	Pjesëmarrja e përfaqësuesit të njësisë për të drejtat e njeriut në rol këshillëdhënës në komisionet vlerësuese të projekteve.	Komisioni ne drejtori, përfaqësuesi i zyrës për të drejtat e njeriut.	X	X	X	X	Vendimi për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të zyrës për të drejtat e njeriut				
	Pajisja e këndeve të lodrave për fëmijët me aftësi të kufizuar.	Shërbimet publike dhe urbanizmi	X	X	X	X	Numri i lodrave të instaluar	3,000	5,000	5,000	5,000
2.2 Janë evituar barrierat për lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara.	Planifikimi i buxhetit komunal për rregullim të lirisë së lëvizjes në objekte publike dhe rrugë.	Drejtorati i shërbimeve publike / Urbanizimi	x	x	x	X	Numri i projekteve të buxhetuara.	15,000	15,000	15,000	15,000
	Subvencionimi i transportit për fëmijë me nevoja të veçanta në arsim në të gjitha shkollat.	DKA	X	X	X	X	Numri i fëmijëve të subvencionuara	20,000	20,000	20,000	20,000
2.3 Janë siguruar hapësirat për parking për personat me aftësi të kufizuara.	Shënjimi i vendeve të parkingut për personat me aftësi të kufizuara.	Drejtoria e Urbanizmit ose Drejtoria për shërbime publike	x	x	x	x	Numri i parkingjeve të shënuara.	4,000	4,000	4,000	4,000
2.4 Është ngritur vetëdija e popullatës dhe zyrtarëve lidhur me mungesën e qasjes për	Prodhimi dhe publikimi i fushatave për vetëdijesim në mediat sociale.	Zyra për të drejtat e njeriut	x	x	x	x	Numri i materialeve të prodhuara	400	400	400	400

personat me aftësi të kufizuara.											
Objektiva 3	Përmirësimi i kushteve ne institucionet edukativo-arsimore për gjithë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara										
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit				Indikatorët	Buxheti			
			2024	2025	2026	2027		2024	2025	2026	2027
3.1 Është siguruar buxhet komunal për mbulim e mëditjeve të anëtarëve të ekipit vlerësues për punën jashtë orarit.	Planifikimi i buxhetit komunal për mbulim të mëditjeve të anëtarëve të ekipit vlerësues.	Drejtoria e Arsimit	X	X	X	X	Shuma e buxhetit të planifikuar	4,200	4,200	4,200	4,200
3.2 Janë ngritur kapacitetet e Ekipit Vlerësues Komunal si dhe të edukatorëve dhe mësimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.	Organizimi i trajnimeve për anëtarët e ekipit vlerësues komunal dhe këmbimi i përvojave me ekipet tjera komunale	DKA / OJQ	X	X	X	X	Numri i trajnimeve të mbajtura. Numri i takimeve me ekipet tjera komunale		4,000	4,000	4,000
3.3 Është përmirësuar furnizimi me mjete didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim	Planifikimi i buxhetit për mjete didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim.	DKA / Asistenti/ja për fëmijë	X	X	X	X	Kontrata kornizë	3,000	4,000	5,000	6,000

3.4 Është rritur numri i asistentëve në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara	Planifikimi i buxhetit për punësimin e 40 asistentëve në shkolla dhe shpërndarjes proporcionale të tyre, sipas nevojave të fëmijëve dhe shkollave.	DKA/Organizatat ndërkombëtare që operojnë në Kosovë	X	X	X	X	Numri i asistentëve të punësuar.		20,000	20,000	20,000
3.5 Është rritur organizimi i aktiviteteve rekreative për fëmijë me aftësi të kufizuara.	Planifikimi i buxhetit për mbështetje të aktiviteteve rekreative me fëmijë, të organizuara nga OJQ-të që punojnë me persona me aftësi të kufizuara.	DKA / DKRS / OJQ	X	X	X	X	Numri i aktiviteteve të organizuara	1,500	1,500	1,500	1,500
	Organizimi i aktiviteteve për shënjimin e ditëve të veçanta nga komuna e Gjilanit.	DKA / DKRS / OJQ	X	X	X	X	Numri i aktiviteteve të organizuara	1,500	1,500	1,500	1,500
3.6 Është rregulluar qasja në shkolla për fëmijë me aftësi të kufizuara.	Planifikimi i buxhetit vjetor për evitim të barrierave në qasje nëpër shkolla (rampat, zgjerimi i dyerve, rregullimi i tualeteve).	DKA / Drejtorati i Urbanizmit	X	X	X	X	Shuma e buxhetit të planifikuar	15,000	15,000	15,000	15,000
	Pajisja e fushave sportive në shkolla me mjete të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara.	DKA / Shërbimet Publike	X	X	X	X	Numri i fushave të pajisura	10,000	10,000	10,000	10,000
3.7 Janë organizuar fushata vetëdijesuese për popullatën për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt edukativ.	Publikimi i materialeve vetëdijesuese në mediat sociale.	Zyra për të drejtat e njeriut	X	X	X	X	Numri i publikimeve Numri i klikimeve në publikime	450	450	450	450

Objektiva 4											
Përmirësimi i mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara.											
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit				Indikatorët	Buxheti			
			2024	2025	2026	2027		2024	2025	2026	2027
4.1 Janë evidentuar personat me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit.	Azhurnimi i databazës së personave me aftësi të kufizuara.	DSHMS	X	X	X	X	Databaza e krijuar. Numri i personave të regjistruar në databazë.	2,000	300	300	300
	Njoftimi dhe inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara për diagnostifikim dhe regjistrim.	DSHMS	X	X	X	X	Numri i publikimeve për inkurajim për t'u regjistruar.	200	200	200	200
	Identifikimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara.	DSHMS	X	X	X	X	Numri i personave të identifikuar. Numri i personave me detaje personale të regjistruara.				
	Inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara për aftësim dhe riaftësim profesional.	DSHMS / qendra për aftësinë e kufizuar / QAP	X	X	X	X	Numri i personave me aftësi të kufizuar që kanë përfituar aftësim dhe trajnim profesional brenda QAP	200	200	200	200
	Angazhimi i zyrës komunale për punësim në njoftim të personave me aftësi të	DSHMS dhe zyra	X	X	X	X	Numri i personave me aftësi të kufizuara të kontaktuar nga zyra				

	kufizuara për aftësim dhe riaftësim.	komunale për punëim					komunale për punësim.				
	Krijimi i mekanizmave financiare komunale për aftësimin dhe riaftësimin profesional në QAP.	Drejtoria për buxhet dhe financa	X	X	X	X	Numri i mekanizmave të krijuar.				
	Avokimi për plotësim të kuotës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat.	Zyra e kryetarit dhe kabineti.	X	X	X	X	Numri i institucioneve dhe kompanive të kontaktuara për lobim.				
4.2 Është ngritur vetëdija e popullatës kundër stigmatizimit të personave me aftësi të kufizuara.	Prodhimi dhe publikimi i fushatave për vetëdijesim në mediat sociale.	Kampanje e përbashkët e DKA / DSHMS/ OJQ	X	X	X	X	Numri i fushatave të publikuara Numri i klikimeve në fushatat e publikuara	200	200	200	200
	Publikimi i spoteve vetëdijesuese në radiostacione lokale.	DSHMS DKA / OJQ / Zyra për informim	X	X	X	X	Numri i spoteve të publikuara	150	150	150	150
	Organizimi i ligjëratave vetëdijesuese në shkolla.	DKA / OJQ	X	X	X	X	Numri i ligjëratave të organizuara Numri i nxënësve të synuar nëpërmes ligjëratave	2,000	2,000	2,000	2,000
	Publikimi i rasteve të suksesit për vetëdijesim të familjeve me anëtarë me aftësi të kufizuar.	DKA / Qendra për aftësinë e kufizuar	X	X	X	X	Numri i publikimeve	200	200	200	200

